




REPUBLIKA KOSOVA / REPUBLIC OF KOSOVO	
AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT / AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE / ANTI-CORRUPTION AGENCY	
Titulli / Title: D.P	Nr. Prot. / Sr. Prot. / Prot. No: 01-4546/11/a
Emri i Autorit / Name of Authority: _____	Data / Datum / Date: 18-11-2011
PRISHTINE	



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova - Republic of Kosova**

**AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT**  
**AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE**  
**ANTI-CORRUPTION AGENCY**

Duke u bazuar në nenin 11 paragrafi 1.1, nenin 5 paragrafi 1.5 dhe nenin 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenin 45 të Rregullorës së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 09.11.2011 nxjerr këtë:

**V E N D I M**

- I. Mbyllet rasti i konfliktit të interesit me numër protokoli AKK –03-3111/11, për z. **Fadil Ismaili** – Drejtor Ekzekutiv në Kostt
  
- II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

**Arsyetim**

Rasti i hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt të mundshëm Interesi në ushtrimin e Funkcionit Publik me numër protokoli AKK-03-3111/11, është trajtuar me të gjitha veprimet e nevojshme ligjore dhe procedurale (Ligji Nr.04/L-051, Neni 18, pika 1).

Pas identifikimit të rastit me dyshimin e bazuar për ekzistimin e konfliktit të interesit, Zyrtarit të lartë i është bërë shkresa e parë njoftuese (12.07.2011).

Kësaj shkrese Zyrtari i Lartë, i është përgjegjur me datën 22.07.2011 përmes e-mailit (kopje e bashkangjitur në dosjen e rastit) bashkë me të cilin na ka dërguar edhe Vërtetimin nga Administrata Tatimore e Kosovës me nr.600664636, me të cilin Zyrtari në këtë rast verteton se biznesi i tij nuk ka obligime tatimore ndaj ATK-së dhe se këtë Vërtetim e ka nxjerr për të ndihmuar procesin e shuarjes së biznesit në fjalë.

Paraprakisht Zyrtari i Lartë kishte nisur procesin e shuarjes së biznesit privat në të cilin shfaqej si person i autorizuar. Njoftimi për shuarje është pjesë e dosjes së rastit, i nxjerr në një nga gazetatat ditore të vendit të datës 22 janar 2011.

Ndërkohë Zyrtari i Lartë ka sjellur edhe Vërtetimin nga ATK-ja , të përmendur më lartë, dhe ka njoftuar se procedura për shuarje po vazhdon dhe së shpejti do të kemi edhe dokumentin Njoftim për shuarje të biznesit.

Pikërisht këtë dokument zyrtari na ka dërguar përmes postës elektronike me datën 01.11.2011, i cili mbanë numrin D.P.03-4380/11 nga protokoli i Agjencisë Kundër Korrupsionit.

Pas analizës së të gjitha shkresave nga dosja e rastit dhe përfundimisht me marrjen e shkresës “Njoftim për shuarjen e biznesit” nga Zyrtari i Lartë, që i është lëshuar nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë (MTI) mbi biznesin në fjalë, kemi konstatuar se është parandaluar situata konflikt interesi, gjithnjë duke u bazuar në Ligjin për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në ushtrimin e funksionit publik (Nr.04/L-051) .

Prandaj në bazë të këtyre veprimeve të kryera u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Drejtorit të DP-së
- Shefit të Divizionit
- Zyrtarit të Lartë, Fadil Ismaili,
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit

  
/ Hasan Preteni /